



Pranuar / Dorozuar Priljeno / Predato Received / Delivered	05.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	3921/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.66/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.958/2020 të datës 22.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.66/2020 të datës 02.03.2020, të parashtruar nga ankuesja

Vendimit me Nr. 02-070/01-0006466/20 të datës 31.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike “Masë Disiplinore” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 04.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.66/2020 të datës 02.03.2020, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2011 në pozitën “Udhëheqëse e Sektorit të Rinisë” në Komunën e Ferizajt, Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport njëherit edhe Mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankueses për këtë periudhë, përmes shkresës me nr.08-1/2-2020-zyrtarisht më datë 15.01.2020 i ka shqiptuar Paralajmërim (Qortimi) me shkrim për shkelje disiplinore, si rezultat i mospërfilljes të hierarkisë institucionale.

Ankuesja kundër Paralajmërim (Qortimi) me shkrim për shkelje disiplinore të datës 15.01.2020, me datë 20.01.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajt.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Ferizajt me datë 31.01.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr.02-070/01-0006466/20, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuses të datës 20.01.2020.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr.02-070/01-0006466/20 të datës 31.01.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, me datë 02.03.2020, parashtron ankesën me numër të protokollit 544/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Vendimi me Nr.02-070/01-0006466/20 i datës 31.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajt është nxjerrë si rezultat i shkeljeve dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale konkretisht Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 09.03.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuses, tek Komuna e Ferizajt, ndërsa me datë 23.03.2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Ferizajt me shkresat e bashkangjitura për lëndën e ankuses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuses, ndërsa me datën 07.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 22.04.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.958/2020, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.05.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 02.03.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.66/2020 e datës 02.03.2020 me numër protokollit 544/2020 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.958/2020 i datës 22.04.2022; Flete kthesë e datës 17.03.2020; E-mail nga D.A. për C.Z. i datës 12.05.2020; E-mail nga C.Z. për D.A. i datës 07.05.2020; E-mail nga C.Z. për D.A. i datës 07.05.2020; Njoftim me nr. protokollit 807/2020 i datës 07.05.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 09.03.2020; Formulari për kërkesë

apo ankesë i datës 20.01.2020; Vendim me numër Nr.02-070/01-0006466/20 i datës 31.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajit; Vërtetim i datës 27.01.2020; Paralajmërimi Qortimi me shkrim për shkelje dicitpline me nr. 08-1/2-2020 i datës 15.01.2020; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajit i datës 20.01.2020; E-mail nga D.A. për A.A. i datës 08.01.2020; Njoftim i datës 08.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 17.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 21.01.2020; Autorizim i datës 06.09.2019; Marrëveshje e Bashkëpunimit e datës 12.07.2019; Aneksi - A Plani Buxhetor; Njoftim i datës 21.11.2019; Vendim i datës 01.07.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.A. i datës 17.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.A. i datës 03.01.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.A. i datës 28.12.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i D.A. i datës 28.12.2016; Akt Emërim i D.A. i datës 01.07.2011; Letra e Emërimit e D.A. i datës 02.09.2002; Njoftim i datës 16.07.2008; Dëshmi nga Medical Institute Fati im ¼ faqe për D.A.; Letërnjoftimi i D.A.; Dëshmi për komunikim telefonik; E-mail nga D.A. për dkrs-ferizaj@hotmail.com i datës 11.01.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 01.02.2019; E-mail nga D.A. për Z.B. i datës 05.02.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 06.02.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 06.02.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 14.02.2019; Raport narrativ i datës 14.02.2019; E-mail nga D.A. për dkrs-ferizaj@hotmail.com i datës 08.02.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 04.03.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 14.03.2019; Organizimi i panairit të punës Ferizaj; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 18.03.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 27.03.2019; Raport narrativ i datës 10.04.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 12.04.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 18.04.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 22.04.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 08.05.2019; Projekt propozim për realizimin e aktivitetet kulturo-sportiv, argëtues dhe edukativ i datës 07.05.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 15.05.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 20.05.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 21.05.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 20.06.2019; E-mail nga D.A. për D.A. i datës 20.06.2019; E-mail nga I.S.H. për B.F. i datës 11.06.2019; E-mail nga I.S.H. për B.F. i datës 17.05.2019; E-mail nga I.S.H. për B.F. i datës 15.05.2019; E-mail nga B. për I.S.H. i datës 15.05.2019; E-mail nga I.S.H. për B. i datës 15.05.2019; E-mail nga B. për I.S.H. i datës 14.05.2019; E-mail nga I.S.H. për U.S. i datës 18.04.2019; E-mail nga U.S. për I.S.H. i datës 18.04.2019; E-mail nga U.S. për I.S.H. i datës 18.04.2019; E-mail nga U.S. për I.S.H. i datës 16.04.2019; E-mail nga U.S. për I.S.H. i datës 12.03.2019; E-mail nga U.S. për I.S.H. i datës 12.03.2019; E-mail nga D.A. për F.H. i datës 12.09.2019; E-mail nga D.A. për A.R. i datës 18.09.2019; E-mail nga D.A. për V.J. i datës 23.09.2019; Konkurs për trajner ekspert/e; E-mail nga D.A. për R.A. i datës 15.10.2019; E-mail nga D.A. për dkrs-ferizaj@hotmail.com i datës 04.11.2019; Raport mujor nga data 01 tetor deri me datë 31 tetor; E-mail nga D.A. për K.SH. i datës 04.12.2019; E-mail nga D.A. për zhinipotoku90@hotmail.com i datës 04.12.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 04.12.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 04.12.2019; E-mail nga F.V. për A.R. etj i datës 16.12.2019; E-mail nga D.A. për zhinipotoku90@hotmail.com i datës 20.12.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 24.12.2019; Raport i datës 24.12.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 24.12.2019; Njoftim i datës 24.12.2019; E-mail nga D.A. për A.T. etj. I datës 27.12.2019; E-mail nga D.A. për F.H. etj. I datës 26.12.2019; E-mail nga D.A. për F.H. etj. I datës 26.12.2019; E-mail nga R.A. për D.A. etj. I datës 26.12.2019; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 13.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 14.01.2020; Koktej përmbyllës i datës 17.01.2020; E-mail

nga D.A. për XH.SH. i datës 14.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 15.01.2020; Proces nga Komisioni i datës 14.01.2020; Votimi për aplikantët i datës 13.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 17.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 17.01.2020; Koktej përmbyllës i datës 17.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 20.01.2020; E-mail nga A.K. për D.A. etj. I datës 14.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 21.01.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 21.01.2020; E-mail nga D.A. për dkrs-ferizaj@hotmail.com i datës 24.01.2020; Vendim me nr.9/10 i datës 26.12.2019; Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për dhënien e dekoratave 01 nr.27 datë 31.03.2015; Komunikimet përmes telefonit me SMS nga D.A. me Drejtoreshën XH.SH. faqe 1/8; Shkresë nga Drejtoresha XH.SH. për hyrje dalje nga orari i punës për D.A. e datës 16.12.2019; Shkresë nga Drejtoresha XH.SH. për hyrje dalje nga orari i punës për D.A. e datës 18.12.2019; Shkresë nga Drejtoresha XH.SH. për hyrje dalje nga orari i punës për D.A. e datës 16.12.2019; Shkresë nga Drejtoresha XH.SH. për hyrje dalje nga orari i punës për D.A. e datës 17.12.2019; Dëshmi për hyrje dalje për D.A. faqe 1/8; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 30.03.2020; Shkresë e datës 22.04.2020; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 23.03.2020; E-mail nga D.A. për XH.SH. i datës 17.01.2020; Shkresë nga D.A. për XH.SH. faqe 1/3; E-mail nga D.A. për A.A. i datës 08.01.2020; Njoftim i datës 08.01.2020; Konkurs vullnetari i vitit 2019; E-mail nga D.A. për zhinipotoku90@hotmail.com i datës 17.01.2020; Vendim me nr.7/18 i datës 01.07.2019; Dëshmi nga Medical Institute Fati im ¼ faqe për D.A.; Letërnjoftimi i D.A.; E-mail nga F.V. për A.B. i datës 15.06.2020; Vendim për shuarjen e masës disiplinore me nr. 01-19/22 i datës 17.01.2022; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 21.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuses, është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.958/2020 të datës 22.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me qëllim të vendosjes në mënyrë sa më meritore, më datë 15.06.2022 kemi kërkuar informata zyrtare nga Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Komunën e Ferizajt nëse masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuses është shuar, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar më datë 21.06.2022 ka pranuar njoftimin nga Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Komunën e Ferizajt se ndaj ankuses masa disiplinore "paralajmërimi me shkrim" e datës 15.01.2020, është shuar dhe është hequr nga dosja personale, përmes Vendimit Nr.01-19/22 të datës 17.01.2022 të cilën ankuesja e ka pranuar dhe nënshkruar.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të aplikueshëm në kohën e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuses, konkretisht Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i aplikueshëm nga data 09.07.2020, i cili në nenin 83 paragrafi 15, ka përcaktuar se: "Masat disiplinore, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë edhe sipas këtij ligji. Zbatimi dhe fshirja e masës do të bëhet sipas këtij ligji".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ndaj ankueses është shuar masa disiplinore "paralajmërimi me shkrim" siç parashihet edhe me dispozitat e nenit 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 14 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2021 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, atëherë çdo vendim tjetër nuk do të kishte efekt juridik, meqë ankuesja nga momenti kur i është shuar masa disiplinore konsiderohet sikurse nuk ka pas asnjëherë masë disiplinore.

Andaj duke u bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur apo i kohë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, si rrjedhojë në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 02.03.2020 të ankueses.


Nga ato që u thanë më lartë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarit të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.66/2020

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

